

Vendim nr. 233, datë 08.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahim, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 08.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Dh) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DHIONISIOS ALFRED BELERI**, përfaqësuar nga avokatja Klodiana Gjyzari, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 340, datë 02.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 59 (87-2023-197), datë 03.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1874, datë 04.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 6 të saj; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 08.05.2023 oficerët e Policisë Gjyqësore (*OPGJ*) të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë kanë referuar te prokurori, ndër të tjera, të dhëna për veprimtarinë e dyshuar kriminale të disa shtetasve në fushën e shitblerjes së votës për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023. Për këtë arsye, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*Prokuroria e Vlorës*) ka regjistruar procedimin penal nr. 489 të vitit 2023 për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*). Në kuadër të këtij procedimi, në datën 12.05.2023, ora 00:14, është kryer kapja në flagrancë e kërkuesit Dhionisios Alfred Beleri dhe në orën 00:38 të kësaj date është kryer kapja në flagrancë e shtetasit tjetër P.K. Më tej, në orën 09:45 të së njëjtës date, është bërë edhe arrestimi në flagrancë i kërkuesit si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të *KP*-së.

2. Me vendimin nr. 205, datë 13.05.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka deklaruar moskompetencën e saj, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore.

3. Në datën 14.05.2023 janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe, me vendimin nr. 194, datë 16.05.2023, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88 ka shpallur kërkuesin fitues. Në vijim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (*KQZ*), me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023, ka vendosur t’i japë kërkuesit mandatin e kryetarit të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë.

4. Në vijim të procesit penal, *GJKKO-ja e Shkallës së Parë*, me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit, vendim që është miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023. Kolegji Penal i

Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 19, datë 01.06.2023 të GJKKO-së së Apelit. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, por Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 19, datë 21.03.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në atë gjykim kërkuesi ka kundërshtuar, ndër të tjera, marrjen në konsideratë nga gjykatat e zakonshme të faktit se ishte i dënuar më parë, referuar aktit “Certifikatë elektronike e z. Dhionisios Alfred Beleri”, datë 12.05.2023, duke pretenduar se, sipas nenit 69 të KP-së dhe akteve të gjendjes gjyqësore, ai konsiderohej i rehabilituar. Gjykata ka vlerësuar se arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për këtë aspekt nuk rezultonte arbitrar dhe se vendimet për kufizimin e lirisë personale ishin arsyetuar mjaftueshëm.

5. Nga ana tjetër, në datën 31.07.2023, kërkuesi ka paraqitur një kallëzim pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), me objekt ndjekjen penale për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi kompjuterik”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuara nga nenet 186, pikat 1 dhe 3, 186/a, pika 2, 248 dhe 300 të KP-së. Në kallëzim është pretenduar se në dosjen penale në ngarkim të kërkuesit janë administruar dy dokumente të falsifikuara, të cilat, sipas tij, ishin me rëndësi për procedimin penal ndaj tij. Konkretisht, dokumenti i parë i pretenduar si i falsifikuar ishte akti “Certifikatë elektronike e z. Dhionisios Alfred Beleri”, datë 12.05.2023, nga e cila ai rezulton i dënuar dhe që është cituar në vendimin nr. 19, datë 01.06.2023 të GJKKO-së së Apelit si një nga provat ku është mbështetur vendimi për caktimin e masës së sigurimit. Ndërkohë, sipas kërkuesit, ai ishte i rehabilituar dhe, në kuptim të nenit 69 të KP-së, konsiderohej i padënuar. Ndërsa dokumenti i dytë i pretenduar si i falsifikuar ishte fotokopja e protokollit të dorëzimit të materialeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e dërguar me shkresën nr. 6761 prot., datë 27.06.2023 të Prokurorisë së Vlorës. Sipas kërkuesit, në rreshtin e fundit të dokumentit të fotokopjuar, me një shkrim që është tërësisht i ndryshëm nga shkrimi në rreshtat e tjerë të dokumentit, është shënuar se në datën 11.05.2023, akti me nr. 5138 i është dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në orën 14:45.

6. Në kallëzim është pretenduar se Prokuroria e Posaçme, edhe pse ishte në dijeni për falsitetin e këtyre akteve, nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim, por e kishte orientuar mbrojtësin e kërkuesit të paraqiste kallëzim në prokurorinë e zakonshme. Po kështu, është pretenduar se GJKKO-ja e Apelit, në vendimin e saj nr. 19, datë 01.06.2023, nuk kishte konstatuar falsitetin e aktit “Certifikatë elektronike e z. Dhionisios Alfred Beleri”, datë 12.05.2023, ndërsa në vendimin

nr. 104, datë 10.07.2023, në lidhje me vleftësimin dhe lejimin e përgjimit ambiantal, nuk kishte konstatuar as falsitetin e shkresës nr. 6761 prot., datë 27.06.2023 të Prokurorisë së Vlorës. Sipas kërkesit, kjo mënyrë të vepruari ishte në kundërshtim me detyrimet që rridhnin nga neni 300 i KP-së, pasi gjykata duhej të paraqiste kallëzim, për më tepër kur një pretendim i tillë ishte ngritur nga palët. Për rrjedhojë, kërkuksi ka pretenduar se gjyqtari i GJKKO-së së Apelit, që kishte dhënë këto dy vendime, kishte konsumuar elementet e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300, pika 1, i KP-së.

7. Po ashtu, sipas kërkesit, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme të ngarkuar me hetimin e procedimit penal nr. 111/2023 ndaj tij kishin konsumuar elementet e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, pasi nuk kishin përmbushur detyrimin ligjor për ushtrimin e ndjekjes penale. Sipas tij, hetimi i pretendimit për falsitetin e dokumenteve përfshihej në kompetencën lëndore të asaj prokurorie, përderisa ato ndodheshin në dosjen e procedimit penal të saj dhe duhej të hetoheshin edhe kryesisht. Gjithashtu, sipas kërkesit, punonjësit që menaxhonin sistemin elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kishin konsumuar veprën penale “Falsifikimi kompjuterik”, të parashikuar nga neni 186/a, pika 2, i KP-së, në lidhje me aktin “Certifikatë elektronike e z. Dhionisios Alfred Beleri”, datë 12.05.2023. Kurse të gjitha subjektet që kishin përdorur këtë akt kishin konsumuar, sipas tij, elementet e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 1, i KP-së. Kërkuksi ka pretenduar se edhe në përpilimin e shkresës nr. 6761 prot, datë 27.06 2023 të Prokurorisë së Vlorës ishin konsumuar veprat penale të parashikuara nga neni 186, pikat 1 dhe 3, të KP-së.

8. Në funksion të këtij kallëzimi, Prokuroria e Posaçme ka kryer disa veprime verifikuese, në përfundim të të cilave, me vendimin e datës 03.08.2023, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se ndjekja penale nuk mund të fillonte, referuar nenit 290, pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi faktet e pretenduara nuk përmbanin elementet e veprave penale të kallëzuara prej kërkesit ose të ndonjë vepre tjetër penale. Kundër këtij vendimi kërkuksi ka paraqitur ankim në gjykatë.

9. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 340, datë 02.10.2023 ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkesit dhe lënien në fuqi të vendimit të datës 03.08.2023 të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal. Sipas asaj gjykate, mungojnë indicie të sakta dhe të rëndësishme që mund të krijonin të dhëna të mjaftueshme për konsumimin e elementeve të veprave penale të pretenduara nga kërkuksi ose të ndonjë vepre tjetër penale. Po

sipas saj, dyshimet e kërkuessit bazoheshin vetëm në pretendimet e tij, të cilat nuk harmonizoheshin ose lidheshin me ndonjë akt ose provë tjetër. Kundër vendimit kërkuessit ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

10. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 59 (87-2023-197), datë 03.04.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke i gjetur të pabazuara shkaqet e ankimit. Sipas asaj gjykate, vendimi i gjykatës së shkallës së parë përmbushte elementet e arsytimit dhe trajtonte të gjitha elementet e kallëzimit, si dhe pretendimet e kërkuessit. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar, gjithashtu, se prokurori e kishte marrë vendimin e mosfillimit të procedimit penal në bazë të nenit 290, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së, pasi kishte kryer veprimet e nevojshme verifikuese për të identifikuar rrethanat, duke administruar dokumente dhe pyetur personat që kishin dijeni për to. Në lidhje me certifikatën elektronike, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se mospërputhja ndërmjet akteve të gjendjes gjyqësore lidhej me subjektin që kërkonte informacionin dhe se certifikata elektronike nuk ishte dokumenti që provonte në mënyrë të plotë gjendjen gjyqësore të një shtetasi, e cila provohej me vërtetimin e gjendjes gjyqësore sipas neneve 481-484 të KPP-së. Ndërsa për fotokopjen e protokollit të dorëzimit të materialeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar të pabazuar pretendimin e kërkuessit, duke vlerësuar se ai nuk mbështetej në ndonjë të dhënë tjetër përveç perceptimit të vet ankuesit. Kundër këtij vendimi kërkuessit ka paraqitur rekurs.

11. Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1874, datë 04.12.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegji, shkaqet e ngritura në rekurs ishin të njëjta me ato të parashtruara në gjykatat më të ulëta, për të cilat kërkuessit kishte marrë përgjigje të arsytuar, ndërsa në rekurs nuk ishte paraqitur ndonjë argument ose shkak ligjor i tillë që të orientonte Gjykatën e Lartë drejt cenimit të vendimeve të gjykatave të faktit. Kolegji Penal ka theksuar se, në shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit për mosfillimin e procedimit penal, gjykata kontrollon natyrën dhe plotësinë e veprimeve të kryera nga prokuroria dhe mund ta prishë vendimin vetëm kur konstaton se veprimet e kryera nuk janë të plota dhe se nevojiten veprime të tjera thelbësore. Në këtë drejtim, ai i është referuar edhe vendimit unifikues nr. 2, datë 19.06.2013, sipas të cilit rrethanat e parashikuara nga neni 290 i KPP-së, në përgjithësi, nuk kërkojnë një proces të ndërlikuar ose kryerjen e veprimeve të rëndësishme hetimore për zbulimin e fakteve që lidhen me fajësinë ose pafajësinë.

12. Në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pretendimet se prokuroria dhe gjykatat nuk kishin vlerësuar drejt faktet dhe provat e paraqitura nga kërkuesi dhe se prokuroria nuk kishte kryer veprime hetimore kishin të bënin me provat dhe mënyrën e vlerësimit të tyre, ndaj dilnin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Megjithatë, ai kolegji ka vlerësuar se, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, GJKKO-ja e Apelit kishte shqyrtuar vendimin e shkallës së parë dhe atë të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, duke analizuar aktet dhe provat e dosjes në raport me ligjin e zbatueshëm, dhe kishte arritur në përfundimin se vendimi për mosfillimin e procedimit penal ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj e prova. Për pretendimet për mungesën e arsytimit dhe për kryerjen nga prokuroria të veprimeve hetimore, në vend të atyre verifikuese, Kolegji Penal ka çmuar se ato ishin shqyrtuar dhe rrëzuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjykata e apelit, ndërsa kërkuesi nuk kishte paraqitur në rekurs ndonjë shkak ligjor konkret për cenueshmërinë e këtij arsytimi. Për pretendimin se vendimi i gjykatës së apelit ishte dhënë në tejkalim të afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 291 i KPP-së, Kolegji Penal ka vlerësuar se tejkalimi i afatit ishte i justifikuar, pasi ajo gjykatë kishte pezulluar gjykimin dhe i ishte drejtuar Gjykatës për kontroll incidental, ndaj ishte e detyruar të priste vendimmarrjen e saj. Në përfundim, Kolegji Penal ka vlerësuar se në vendimmarrjen e GJKKO-së Apelit nuk konstatohej mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore ose me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe vendimi nuk vinte në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

13. Ndërkohë që vijonte procesi gjyqësor në lidhje me vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e kërkuesit, çështja penale ndaj tij është dërguar për gjykim dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 14, datë 05.03.2024, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të KP-së, duke e dënuar me dy vjet burgim. Ky vendim, pas ankimimit nga kërkuesi, është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 26(87-2024-176), datë 25.06.2024. Ndërkohë, sipas njoftimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji Penal i asaj gjykate, në datën 26.03.2026, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit.

14. Në datën 04.05.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet e dhëna në procesin gjyqësor me objekt kontrollin e vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal.

II

Pretendimet e kërkuesit

15. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

15.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

15.1.1. *Së drejtës së aksesit efektiv në gjykatë*, pasi vendimet e kundërshtuara i kanë mohuar të drejtën për të marrë një përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar për pretendimet e tij, si dhe për të kërkuar rivendosjen në vend të së drejtës të cenuar nga autoritetet publike. Konstatimi i falsifikimit do t'i mundësonte kërkuesit përdorimin e tij për të kërkuar rishikimin e vendimit penal të dënimit me burgim sipas nenit 450, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së. Për sa i përket aktit “certifikatë elektronike” të datës 12.05.2023, ai përmban të dhëna të rreme për gjendjen gjyqësore të kërkuesit. Certifikatat elektronike të datave 16.03.2023 dhe 07.06.2023 e pasqyrojnë atë “të padënuar”, ndërsa certifikata elektronike e datës 12.05.2023 “të dënuar”. Nga ana tjetër, vërtetimet e gjendjes gjyqësore të datave 03.04.2023 dhe 23.05.2023 e pasqyrojnë kërkuesin “të rehabilituar”, duke paraqitur kështu të dhëna të ndryshme për të njëjtën gjendje juridike, me pasoja juridike të ndryshme. Certifikata elektronike e datës 12.05.2023 është përdorur për vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit dhe, më tej, është administruar edhe në fashikullin e gjyqimit të çështjes penale. Ndërsa fotokopja e protokollit të dorëzimit të materialeve lidhej me ligjshmërinë e autorizimit të përgjimit mbi të cilin ishin mbështetur akuza dhe më pas dënimi penal ndaj tij. Ky dokument është i falsifikuar materialisht përmes shtimit të një shënimi në rreshtin e fundit, prandaj duhej të kryhej, së paku, një ekspertim grafik, ose të pyetej personi përgjegjës për dorëzimin e akteve në gjykatë. Megjithatë, prokuroria ka vepruar me standarde të ndryshme, pasi për aktet e gjendjes gjyqësore ka marrë deklaratime nga personat përgjegjës, ndërsa për dokumentin tjetër nuk ka kryer asnjë verifikim.

15.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e kundërshtuara janë të paarsyetuara, ndonëse kërkuesi ka paraqitur prova të drejtpërdrejta për ekzistencën e fakteve penale. Kërkuesi nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar për refuzimin e prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe gjykatat nuk kanë dhënë asnjë argument konkret për pretendimet e tij. Në veçanti, gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit se prokuroria, përpara regjistrimit të procedimit penal, kishte kryer veprime me natyrë hetimore, si këqyrja dhe marrja e dokumenteve dhe pyetja e personave që kishin dijeni për rrethanat e kallëzuara, të cilat nuk mund të konsideroheshin thjesht veprime verifikuese. Ato nuk kanë arsyetuar as sesi faktet e kallëzuara, të cilat parashikohen nga KP-ja si vepra penale, përfshiheshin në rastin e mosfillimit, të parashikuar nga neni 290, pika 1, shkronja “ç”, i KPP-së. Gjykata e Lartë është shprehur se arsyetimet e gjykatave janë të mjaftueshme, pa i kthyer përgjigje pretendimit për respektimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtari i GJKKO-së së Apelit, të cilin ai vetë e kishte vënë në dyshim në kërkesën për kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje as pretendimeve se përse nuk përbënte falsifikim pasqyrimi i ndryshëm i të njëjtit fakt juridik në dokumentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe përse nuk duhej të hetohej akti “regjistër protokolli i dorëzimit të materialeve”. Gjykatat nuk kanë shpjeguar se përse rrethanat e kallëzuara përbënin një nga rastet ligjore të mosfillimit të procedimit penal dhe as se cila ishte rruga procedurale që duhej të ndiqte kërkuesi për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar nga veprimet e paligjshme të organit të ndjekjes penale. Për më tepër, përderisa çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, pa seancë publike, detyrimi i gjykatave për t’u dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore ishte edhe më i theksuar.

15.2. *E drejta për të pasur një zgjidhje efektive*, sipas nenit 13 të KEDNJ-së, pasi faktet penale të kallëzuara, që lidhen me falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, kanë të bëjnë me akte dhe fakte të administruara në procesin penal dhe kanë lidhje me vendimin e dënimit të dhënë ndaj kërkuetit. Ekzistenca e këtyre veprave penale nuk mund të vërtetohet nga kallëzuesi, por duhet të verifikohet nga prokuroria, pas kallëzimit ose kryesisht, përmes zhvillimit të hetimeve përkatëse.

Prokuroria nuk mund të refuzojë hetimin e tyre, pasi, së pari, ushtrimi i ndjekjes penale përbën detyrim kushtetues të saj, sipas nenit 148 të Kushtetutës dhe, së dyti, refuzimi i hetimit i mohon kërkuesit mundësinë për të pasur një vendim të formës së prerë për falsifikimin e pretenduar dhe, për rrjedhojë, për të përdorur mjetin e jashtëzakonshëm të ankimit, rishikimin e vendimit penal, sipas nenit 450, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së. Në këtë mënyrë, kërkuesit i është cenuar edhe *e drejta për t’u rehabilituar/zhdëmtuar*, sipas nenit 44 të Kushtetutës, në lidhje me pasojat e shkaktuara atij nga veprimet e paligjshme të autoriteteve publike.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

16. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kriterëve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji do të verifikojë plotësimin e kriterit të legjitimit *ratione personae* të kërkuesit.

18. Për sa i përket legjitimit *ratione personae*, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet

të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë material (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete rezulton se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor që ka pasur për objekt kontrollin e vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal, të vënë në lëvizje prej tij përmes ankimit. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

19. Për sa i përket aspektit material të këtij kriteri legjitimimi, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe duhet të tregojë se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat e aktit të kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

20. Kolegji vëren se procesi gjyqësor objekt i ankimit kushtetues nuk ka pasur për objekt kufizimin e lirisë personale të kërkuesit, përgjegjësinë penale të tij, vlefshmërinë e provave të përdorura ose ligjshmërinë e vendimit të masës së sigurimit personal ose të dënimit, por kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal ndaj personave të tretë. Kjo është një çështje e ndryshme nga procesi për masën e sigurimit personal, në të cilin kërkuesi kishte kundërshtuar drejtpërdrejt ndikimin e statusit të tij si i dënuar ose i rehabilituar në kufizimin e lirisë dhe që ka përfunduar me vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës. Në këtë proces kërkuesi ka kundërshtuar, në thelb, mënyrën e ushtrimit të kompetencës kushtetuese të Prokurorisë së Posaçme për ndjekjen penale të personave të kallëzuar prej tij, konkretisht gjyqtarëve, prokurorëve, punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe subjekteve të tjera që kishin përdorur aktet e pretenduara si të falsifikuara, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi kompjuterik”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuara nga nenet 186, pikat 1 dhe 3, 186/a, pika 2, 248 dhe 300 të KP-së.

21. Sipas kërkuesit, në dosjen penale ndaj tij janë administruar dy dokumente të falsifikuara dhe me rëndësi për procesin penal, konkretisht: (i) certifikata elektronike e datës 12.05.2023, sipas së cilës ai rezultonte i dënuar; (ii) fotokopja e protokollit të dorëzimit të materialeve në gjykatë, në

rreshtin e fundit të së cilës ishte vendosur një shënim me shkrim të ndryshëm nga pjesa tjetër e dokumentit. Ai ka pretenduar se konstatimi me vendim penal i falsifikimit të këtyre akteve do t'i krijonte mundësinë për të kërkuar rishikimin e vendimit penal të dënimit, sipas nenit 450, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së, dhe përmes tij rehabilitimin dhe zhdëmtimin.

22. Kolegji vlerëson se interesi i pretenduar nga kërkuesi është i tërthortë dhe i kushtëzuar nga zhvillimi dhe rezultati i një procedimi penal të ardhshëm ndaj personave të tretë. Rezultati përfundimtar që ai synon nuk rrjedh drejtpërdrejt nga shfuqizimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, por varet nga disa rrethana të ardhshme dhe të pasigurta, përkatësisht nga fillimi i procedimit penal, kryerja e hetimeve, vërtetimi eventual i falsitetit të akteve, marrja e një vendimi penal të formës së prerë dhe, vetëm më pas, mundësia e përdorimit të këtij rezultati në funksion të një kërkesë për rishikimin e vendimit penal të themelit. Fakti që kërkuesi ka kundërshtuar edhe në procesin e masës së sigurimit pasqyrimin e tij si person i dënuar nuk e ndryshon këtë përfundim. Në atë proces ai ka pasur një mjet të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar pasojat e atij informacioni mbi lirinë e tij personale, mjet të cilin e ka ushtruar deri në këtë Gjykatë. Nga ana tjetër, edhe duke pranuar se interesi përfundimtar që kërkuesi synon të mbrojë lidhet me pasojat e dënimit penal, lirinë personale dhe rehabilitimin e tij, vendimet objekt ankimi nuk kanë përcaktuar drejtpërdrejt as fajësinë, as dënimin dhe as statusin e tij juridik. Ato kanë vendosur vetëm për ligjshmërinë e mosfillimit të procedimit penal ndaj personave të kallëzuar prej tij. Për rrjedhojë, shfuqizimi i këtyre vendimeve nuk do të sillte vetvetiu rivendosjen e lirisë personale, shfuqizimin e dënimit ose rehabilitimin e kërkuesit.

23. Po kështu, Kolegji vëren se kërkuesi ka identifikuar një lidhje ndërmjet certifikatës elektronike të datës 12.05.2023 dhe procesit për masën e sigurimit personal, pasi ajo është marrë në konsideratë në vlerësimin e personalitetit dhe rrezikut të tij. Megjithatë, kjo lidhje nuk krijon një interes kushtetues të drejtpërdrejtë në procesin objekt ankimi. Kushtetutshmëria e kufizimit të lirisë personale, përfshirë arsyetimin e gjykatave të zakonshme për statusin e kërkuesit si i dënuar ose i rehabilituar, është shqyrtuar përfundimisht nga Gjykata me vendimin nr. 19, datë 21.03.2024. Në atë vendim Gjykata ka evidentuar se Kolegji Penal kishte arsyetuar se edhe sikur kërkuesi të konsiderohej i padënuar, sjellja e tij e mëparshme mund të merrej në konsideratë në vlerësimin e rrezikut të largimit dhe ka çmuar se ky arsyetim nuk rezultonte arbitrar. Vendimi nr. 19, datë 21.03.2024 nuk ka përcaktuar nëse certifikata elektronike ishte ose jo e falsifikuar, por ka zgjidhur pretendimin kushtetues që lidhej me pasojën e pasqyrimin të kërkuesit si person i dënuar në

procesin e kufizimit të lirisë. Për rrjedhojë, procesi aktual për mosfillimin e ndjekjes penale ndaj personave të tretë nuk mund të shërbejë si mjet i tërthortë për rihapjen e vlerësimit kushtetues të atij kufizimi. Ndërsa për ndikimin e certifikatës elektronike në vendimin përfundimtar për fajësinë, kërkuesi nuk ka argumentuar në mënyrë konkrete sesi ajo ka ndikuar në përcaktimin e faktit penal ose në rezultatin përfundimtar të procesit, për më tepër që në këtë ankim kushtetues nuk kundërshtohet vetë procesi përfundimtar i dënimit. Edhe për fotokopjen e protokollit të dorëzimit të materialeve, kërkuesi nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme sesi shënimi i pretenduar si i falsifikuar ka ndikuar drejtpërdrejt në vlefshmërinë e përgjimit dhe, më tej, në vendimin përfundimtar të dënimit. Kolegji vlerëson se vetëm fakti se këto akte janë administruar në fashikullin penal nuk mjafton për të krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet vendimeve objekt ankimi dhe cenimit të pretenduar të të drejtave kushtetuese të kërkuesit.

24. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se Kushtetuta nuk garanton të drejtën për të filluar ndjekjen penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre, në të njëjtën mënyrë sikundër është shprehur edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me mbrojtjen e të drejtave konventore në këtë drejtim (*shih Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006*). Një interes i tillë mund të marrë dimension kushtetues vetëm kur lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e një të drejte themelore të kërkuesit dhe kur akti i kundërshtuar ka sjellë pasoja reale, konkrete dhe vetjake për të. Në rastin konkret, Kolegji vëren se mbrojtja e drejtpërdrejtë e lirisë personale të kërkuesit, në lidhje me përdorimin e statusit të tij si person i dënuar, është realizuar në procesin gjyqësor për masën e sigurimit personal, të përfunduar edhe në juridiksionin kushtetues, ndërsa lidhja që ai krijon ndërmjet procedimit penal ndaj personave të tretë dhe rishikimit të dënimit të tij mbetet eventuale dhe e kushtëzuar. Në këto rrethana, kërkuesi nuk ka arritur të tregojë se cenimi i të drejtave të tij kushtetuese buron drejtpërdrejt nga vendimet gjyqësore që kanë lënë në fuqi vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal.

25. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimet që lidhen me cenimin e aksesit në gjykatë, standardin e arsyetimit, zgjidhjen efektive dhe të drejtën për rehabilitim/zhdëmtim, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi nuk ka arritur të justifikojë një interes kushtetues të drejtpërdrejtë dhe real në procesin objekt ankimi.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.